

Tirana Auto
Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur
më 31 dhjetor 2015



PËRMBAJTJA:

	FAQE
PASQYRAT FINANCIARE:	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	1
PASQYRA E PERFORMANCËS	2
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	3
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE	4
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE	5-19



Tirana Autosh.p.k
(Vlerat janë në Lek)

**Pasqyra e Pozicionit Financiar
më 31 dhjetor 2015**

	Shënime	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
AKTIVET			
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare	4	16,261,312	28,491,719
Llogari të arkëtueshme tregëtare	5	75,365,145	64,038,914
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	6	9,225,418	2,930,978
Të tjera llogari të arkëtueshme	7	11,770,524	52,754,582
Inventarë	8	226,580,622	225,730,729
Parapagime dhe shpenzime të shtyra	9	965,054	1,234,829
Total aktive afatshkurtra		340,168,075	375,181,751
Aktivitet afatgjata			
Aktive afatgjata materiale	10	258,462,299	225,694,594
Të tjera llogari të arkëtueshme	11	-	100,000
Total aktive afatgjata		258,462,299	225,794,594
Total aktive		598,630,374	600,976,345
DETYRIMET			
Detyrime afatshkurtra			
Hua afatshkurtra	12	24,141,808	29,240,931
Llogari të pagueshme tregtare	13	176,030,832	231,101,928
Detyrime tatimore	14	394,112	327,770
Parapagime të marra	15	35,422,468	1,160,667
Të tjera detyrime	16	-	82,536,685
Total detyrime afatshkurtra		235,989,220	344,367,981
Detyrime afatgjata			
Hua afatgjata	17	291,724,270	193,489,383
Total Detyrime afatgjata		291,724,270	193,489,383
Totali i detyrimeve		527,713,490	537,857,364
KAPITALI			
Kapitali i nënshkruar	18	2,000,000	100,000
Rezerva ligjore		3,558,760	3,391,266
Rezerva të tjera		59,460,221	56,277,836
Fitimi i ushtrimit		5,897,903	3,349,879
Total kapitali		70,916,884	63,118,981
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		598,630,374	600,976,345

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 19, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

TIRANA AUTO sh.p.k.
TIRANA - ALBANIA

NUMER: 1823400979

Tirana Autosh.p.k

(Vlerat janë në Lek)

**Pasqyra e Performancës
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015**

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	19	956,816,157	1,273,197,242
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit		464,295	(17,025,597)
Lenda e pare dhe materiale te konsumueshme dhe shpenzime te tjera		(848,032,171)	(1,181,523,761)
1) Lënda e parë, materiale të konsumueshme dhe shpenzime të tjera	20	(815,438,244)	(1,133,108,956)
2) Të tjera shpenzime	21	(32,593,927)	(48,414,805)
Shpenzime te personelit	22	(14,103,866)	(10,849,497)
1) Paga dhe shpërblime		(12,131,868)	(9,362,542)
Shpenzime të sigurimeve		(1,971,998)	(1,486,955)
2) shoqërore/shëndetësore		(58,077,329)	(41,349,509)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	10	(675,086)	(73,820)
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	23	(28,683,953)	(15,987,634)
Shpenzime financiare	24		
1) Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme		(28,385,750)	(16,020,034)
2) Shpenzime të tjera financiare		(298,203)	32,400
Pjesë e fitimit/humbjes nga pjesëmarrjet			
Fitimi/humbja para tatimit		7,708,047	6,387,424
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	25	(1,810,144)	(3,037,545)
1) Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin		(1,810,144)	(3,037,545)
2) Shpenzimi aktual i tatimit të shtyrë		-	-
Fitimi/humbja e vitit		5,897,903	3,349,879
Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse për vitin		-	-
Totali i të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse për vitin		-	-
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin		5,897,903	3,349,879

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 19, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.



Blendi Shkurti
Blendi Shkurti

Tirana Autosh.p.k*(Vlerat janë në Lek)***Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015**

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 19, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

	Kapitali i nënshkruar	Rezerva Ligjore	Rezerva të tjera	Pashpërndara	Fitimet e Humbja e vitit	Fitim /	Totali
Pozicioni më 1 janar 2014	100,000	3,391,266	29,615,812		26,662,024		59,769,102
Transferim në rezerva të tjera			26,662,024		(26,662,024)		-
Totali i të ardhura gjithpërfshirëse për vitin:					3,349,879		3,349,879
Emetimi i kapitalit të nënshkruar							-
Pozicioni më 31 dhjetor 2014	100,000	3,391,266	56,277,836	-	3,349,879		63,118,981
Transferim në rezerva të tjera			3,349,879		(3,349,879)		-
Të ardhura totale gjithpërfshirëse për vitin:					5,897,903		5,897,903
Emetimi i kapitalit të nënshkruar	1,900,000						1,900,000
Pozicioni më 31 dhjetor 2015	2,000,000	3,391,266	59,627,715	-	5,897,903		70,916,884

Pasqyrat financiare së bashku me shënimet shpjeguese për vitin ushtrimor të mbyllur më 31 dhjetor 2015 u aprovuan nga Administratorja e shoqërisë më _____ dhe u nënshkruan si më poshtë nga:

Z. Blend Llaci
Administrator



Merita Gashi
Përgatiti

Tirana Autosh.p.k

(Vlerat janë në Lek)

**Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015**

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014
Flukset e parasë nga aktivitetet operative		
Fitim / Humbja e vitit	5,897,903	3,349,879
Rregullimet për shpenzimet jomonetare:		
Shpenzimet financiare jomonetare	1,810,144	3,037,545
Shpenzimet për tatimin mbi fitimin jomonetar	58,077,329	41,349,509
Fluksi i mjeteve monetare i përfshirë në aktivitetet investuese:		
Fitim nga shitja e aktiveve afatgjata materiale	-	17,921,667
Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet e shfrytëzimit:		
Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	21,923,019	(102,994,330)
Rënie/(rritje) në inventarë	(849,893)	(185,000,723)
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme	(103,279,638)	261,499,458
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit	(16,421,136)	39,163,005
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale	(116,022,599)	(182,817,313)
Arkëtime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale	25,177,564	41,696,212
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit	(90,845,035)	(141,121,101)
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit		
Arkëtime nga emetimi i kapitalit	1,900,000	
Të hyra/(Pagesa e huave)	93,135,764	126,341,068
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit	95,035,764	126,341,068
Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare	(12,230,407)	24,382,972
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar	28,491,719	4,108,747
Efekti i luhatjeve të kursit të këmbimit të mjeteve monetare		
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor	16,261,312	28,491,719
4		

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 19, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.



1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria Tirana Auto Shpk është krijuar në vitin 2008, e rregjistruar në QKR me datë 18.11.2008. Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave përkatëse të ligjit "Për Shoqëritë tregtare" dhe nga statuti i saj.

Tirana Auto sh.p.k. është një shoqëri shqiptare, me ortak të vetëm Z. Benon Dede, shtetas shqiptar i cili zotëron 100% të kuotave të kapitalit të shoqërisë.

Kapitali i shoqërisë është 2,000,000 lekë.

Administrator i shoqërisë është Z. Blendi Llaci.

Selia e shoqërisë është : Autostrada Tiranë-Durrës, km 1, Rruga dytësore, Kashar, Tirane. Ajo është regjistruar pranë organeve tatimore të rrethit Tiranë me NIPT K82318007Q.

Aktiviteti kryesor i kësaj shoqërie është import automjeteve, shërbim riparimi i tyre, servis universal.

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.9228, datë 29 prill 2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

Në bazë të urdhrin nr.64 datë 22.7.2014 "Për shpalljen e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre", Ministria e financave vendosi të bëjë të detyrueshme zbatimin e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara duke filluar nga 1 janar 2015.

Ky urdhrë hyri në fuqi me fletoren zyrtare nr.119, datë 1 gusht 2014.

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumë e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:



2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)

2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuar të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50% , në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

2.6. Krahasueshmëria e informacionit kontabël

Siç paraqitet në Standardin Kombëtar të Kontabilitetit të përmirësuar nr.1, në rastet e një ndryshimi në paraqitjen e pasqyrave financiare si pasojë e kërkesave të një standardi të ri, një përmirësimi në standard apo një ndryshimi në ligjin për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", informacioni krahasues duhet të riparaqitet për të korresponduar me paraqitjen e re, përveç rasteve kur riparaqitja e informacionit krahasues nuk mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

Informacioni krahasues për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014 është riparaqitur për të korresponduar me paraqitjen e re të pasqyrave financiare siç kërkohej nga Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuar.

3. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisht të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	2015	2014
Euro/LEK	137.28	140.14
USD/LEK	125.79	115.23



3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivitet financiarë çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitet financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitet. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dheshpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiare (vazhdim)

Zhvierësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvierësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvierësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivitetet financiare të rëndësishme testohen për zhvierësim në mënyrë individuale. Aktivitetet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvierësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvierësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvierësimi. Për aktivitetet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.3. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

3.4. Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivitetet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvierësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitetit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitetit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivitetit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivitetit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktiviteti afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjesë të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.



3. Politikat Kontabël (vazhdim)**3.4. Aktive afatgjata materiale (vazhdim)***iii. Amortizimi*

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2015 dhe 2014 është si më poshtë:

Kategoria e AQT-ve	Norma e Amortiz në %		Metoda e llogaritjes
	2015	2014	
Toka	0 %	0 %	Mbi vlerën e mbetur të AAM-ve
Ndërtime e instalime	5 %	5 %	
Makineri e Pajisje	20 %	20 %	
Mjete transporti	20 %	20 %	
Pajisje zyre	20 %	20 %	
Pajisje kompiuterike	25 %	25 %	
Instrumenta dhe vegla pune	20 %	20 %	

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit. Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3.5. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësi ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

3.6. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3.7. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.8. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.9. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2015 është 15% (2014: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundshme që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

3.10. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

3.11. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3.12. Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen

e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.13. Aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

4. Mjete monetare

Mjetet monetare në arkë dhe bankë detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	<u>31 dhjetor 2015</u>	<u>31 dhjetor 2014</u>
Mjete monetare në Arkë	20,582	488,991
Mjete monetare në Bankë	16,240,730	28,002,728
	<u>16,261,312</u>	<u>28,491,719</u>

5. Llogari të arkëtueshme tregtare

Llogaritë e arkëtueshme tregtare më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2015</u>	<u>31 dhjetor 2014</u>
Klientë	75,365,145	64,038,914
	<u>75,365,145</u>	<u>64,038,914</u>

6. Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura

Llogaritë e arkëtueshme nga palët e lidhura më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2015</u>	<u>31 dhjetor 2014</u>
Ortaku	9,225,418	2,930,978
	<u>9,225,418</u>	<u>2,930,978</u>



7. Të tjera llogari të arkëtueshme

Llogaritë të tjera të arkëtueshme më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2015</u>	<u>31 dhjetor 2014</u>
Tatim fitimi i parapaguar	3,578,895	3,893,410
TVSH	2,966,486	18,736,857
Te drejta te tjera	5,225,143	30,124,315
	<u>11,770,524</u>	<u>52,754,582</u>

8. Inventari

Gjendjet e inventarit më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 përbëhen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2015</u>	<u>31 dhjetor 2014</u>
Makina	198,367,933	200,328,809
Pjese kembimi	26,311,310	23,717,750
Inventar l imet	1,901,379	1,684,170
	<u>226,580,622</u>	<u>225,730,729</u>

9. Parapagime dhe shpenzime të shtyra

Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 përbëhen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2015</u>	<u>31 dhjetor 2014</u>
Parapagime	965,054	-
Shpenzime te shtyra	-	1,234,829
	<u>965,054</u>	<u>1,234,829</u>



Tirana Auto sh.p.k
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
(Vlerat janë në Lek)

10. Aktive afatgjata materiale

	Ndërtesa	Mjete transporti	Të tjera	Totali
Kosto				
Gjendja më 1 janar 2014	-	283,114,372	3,447,288	286,561,660
Shtesa		176,601,538	6,215,775	182,817,313
Nxjerrje jashtë përdorimit		(140,458,532)		(140,458,532)
Gjendja më 31 dhjetor 2014	-	319,257,378	9,663,063	328,920,441
Shtesa	1,410,883	113,829,000	782,716	116,022,599
Nxjerrje jashtë përdorimit		(69,601,166)		(69,601,166)
Gjendja më 31 dhjetor 2015	1,410,883	363,485,212	10,445,779	375,341,874
Amortizimi i akumuluar				
Gjendja më 1 janar 2014	-	141,539,844	1,177,147	142,716,991
Amortizimi i vitit		40,082,632	1,266,877	41,349,509
Nxjerrje jashtë përdorimit		(80,840,653)		(80,840,653)
Gjendja më 31 dhjetor 2014	-	100,781,823	2,444,024	103,225,847
Amortizimi i vitit	41,360	56,519,635	1,516,334	58,077,329
Nxjerrje jashtë përdorimit		(44,423,601)		(44,423,601)
Gjendja më 31 dhjetor 2015	41,360	112,877,857	3,960,358	116,879,575
Vlera neto kontabël				
Gjendja më 31 dhjetor 2014	-	218,475,555	7,219,039	225,694,594
Gjendja më 31 dhjetor 2015	1,369,523	250,607,355	6,485,421	258,462,299



TiranaAuto sh.p.k
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

(Vlerat janë në Lek)

11. Të tjera llogari të arketueshme

Gjate vitit 2015 ortaket kane likujduar vleren e kapitalit te palikujduar prej 100,000 leke.

12. Hua afatshkurtër

Huatë afatshkurtra për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2015</u>	<u>31 dhjetor 2014</u>
Hua nga Bankat (overdafte)	14,014,000	14,014,000
Hua nga subjekte te tjera	10,127,808	15,226,931
	<u>24,141,808</u>	<u>29,240,931</u>

13. Llogari të pagueshme tregtare

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2015</u>	<u>31 dhjetor 2014</u>
Të pagueshme ndaj furnitoreve	176,030,832	230,920,586
Furnitore per fatura te pamberritura	-	181,342
	<u>176,030,832</u>	<u>231,101,928</u>

14. Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2015</u>	<u>31 dhjetor 2014</u>
Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	297,648	254,555
Tatimi mbi të ardhurat personale	96,464	73,215
	<u>394,112</u>	<u>327,770</u>

15. Parapagime të marra

Parapagime të marra më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2015</u>	<u>31 dhjetor 2014</u>
Parapagime te marra	35,422,468	1,160,667
	<u>35,422,468</u>	<u>1,160,667</u>



16. Të tjera detyrime

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Detyrime te tjera	-	82,226,032
Paga dhe shperblime	-	310,653
	-	82,536,685

17. Hua afatgjatë

Huatë afatgjata për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Hua afatgjata nga bankat	206,404,495	194,862,494
Leasing	9,815,775	(1,373,111)
Të tjera	75,504,000	-
	291,724,270	193,489,383

18. Kapitali

	31 dhjetor 2015				31 dhjetor 2014			
	Kuotat	Vlera nominale	Vlera e kapitalit	Në %	Kuotat	Vlera nominale	Vlera e kapitalit	Në %
Benon Dede	100	20,000	2,000,000	100%	100	1,000	100,000	100%
	100	20,000	2,000,000	100%	100	1000	100000	100%

Në bazë të Vendimit nr. , datë 11 nëntor 2015, shoqëria ka rritur kapitalin e saj themeltarme 1,900,000 Lek, duke duke përdorur mjetet monetare nga ortaku i vetëm.

19. Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 detajohen si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
Shitje Automjete	443,417,549	678,547,532
Te ardhura nga leasing	42,205,473	13,516,215
Te ardhura nga servisi	116,215,860	102,847,769
Te ardhura nga ndermjetesimi per shitje	354,977,275	478,285,726
	956,816,157	1,273,197,242



19. Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit (vazhdim)

Rakordimi i të ardhurave me deklaratat e TVSH-së:

	<u>31 dhjetor 2015</u>
Rakordimi i të ardhurave me FDP-ne	1,016,685,191
Qarkullim i tatueshëm	(34,261,801)
Parapagimet	
Zbritet vlera kontabel neto e AAM-ve të shitura përfshirë në zërin "Të ardhura të tjera të shfrytëzimit"	(25,177,564)
Shtohen diferencat e kursit përfshirë në zërin "Të ardhura të tjera të shfrytëzimit"	34,626
Shuma e qarkullimit e korrektuar	957,280,452
Sipas Kontabilitetit	957,280,452
Diferenca	<u><u>-</u></u>

20. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit përfshijnë fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit nga aktiviteti tregtar, rezultatin nga shitja e AAM-ve dhe të ardhura të tjerabalanca e së cilave më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 paraqitet si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014</u>
Te ardhura nga qera automjete	-	3,669,304
Te ardhura nga shitje automjete, aktive (a)	-	(15,333,176)
Te ardhura të tjera	429,669	4,610,372
Fitim / Humbje nga kursi i këmbimit (b)	34,626	(9,972,097)
Të tjera shitje e shërbime	-	-
	<u>464,295</u>	<u>(17,025,597)</u>

a) Rezultati nga shitja e AAM-ve:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014</u>
Të ardhura nga shitja e AAM-ve	25,177,564	41,696,212
Vlera kontabël neto e AAM-ve të shitura	(25,177,564)	(57,029,388)
	<u>-</u>	<u>(15,333,176)</u>

b) Rezultati nga kursi i këmbimit

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014</u>
Fitim nga kursi i këmbimit	13,511,769	398,357
Humbje nga kursi i këmbimit	(13,477,143)	(10,370,454)
	<u>34,626</u>	<u>(9,972,097)</u>



TiranaAuto sh.p.k
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
(Vlerat janë në Lek)

21. Lënda e pare dhe materiale të konsumueshme

Materiale të konsumueshme dhe shpenzime të tjera detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014</u>
Mallra, automjete land rover	305,041,723	396,449,195
Mallra pjese kembimi, land rover	28,934,117	9,673,275
Mallra, automjete tata, mitsubishe etj	92,784,226	219,956,446
Shpenzime GPS	1,238,537	1,391,003
Siguracione automjete	12,513,105	11,188,948
Mirembajtje auto, taksa , transporte, doganore	5,189,775	5,064,256
Asistence, trainime dhe debit note	19,471,383	13,087,128
Mallra, automjete hyundai	350,265,378	476,172,534
Te tjera	-	126,171
	<u>815,438,244</u>	<u>1,133,108,956</u>

22. Të tjera shpenzime

Shpenzimet e tjera detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014</u>
Shpenzime qeraje	12,317,073	11,300,715
Shpenzime postare e tel	539,209	277,631
Shpenzime bankare	2,209,235	4,382,296
Shpenzime te tjera, mirembajtje, kancel etj	854,266	685,285
Shpenzime te tjera, dhe rbs	5,394,810	882,679
Gjoha dhe demshpermbime	-	-
Mirembajtje e riparime	149,601	1,937,821
Shpenzime reklama, publicitet	1,321,236	2,792,242
Komisione dhe honorare	480,000	2,209,704
Udhetime e dieta	1,276,350	1,546,160
Shpenzime lende djegese	482,972	458,440
Shpenzim energji, avull, uje	538,937	139,405
Takasa dhe tarifa vendore	2,017,928	1,482,804
Te tjera nga shitje aqt, etj	-	-
Te tjera korente,	2,366,147	4,156,470
Shpenzime konsumi inventar l imet, llog 327	-	-
Shpenzime tvsh shitje aqt	-	3,048,238
Shpenzime komisione lc dhe te tjera	951,700	10,048,087
Shpenzime pjes panairre	527,450	3,066,828
Humbje nga gabimet e lejuara	1,167,013	-

TiranaAuto sh.p.k
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
(Vlerat janë në Lek)

<u>32,593,927</u>	<u>48,414,805</u>
-------------------	-------------------

23. Shpenzime të personelit

Shpenzimet e personelit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 detajohen si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014</u>
Shpenzime për paga	12,131,868	9,362,542
Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	1,971,998	1,486,955
	<u>14,103,866</u>	<u>10,849,497</u>

24. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit

Shpenzimet e tjera të shfrytëzimit paraqesin gjobat dhe penalitetet për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014</u>
Gjoha dhe dëmshpërblime	675,086	73,820
	<u>675,086</u>	<u>73,820</u>

25. Të ardhura dhe shpenzime financiare

Të ardhurat apo shpenzimet financiare përfshijnë të ardhurat nga interesat dhe rezultatit nga kursi i këmbimit që lidhet me aktivitetin financiar të shoqërisë. Ky zë detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014</u>
Të ardhura nga interesat	7,569	31,323
Shpenzime për interesa	(28,393,319)	(16,051,357)
Shpenzime financiare	(501,654)	-
Të ardhura financiare	203,451	32,400
	<u>(28,683,953)</u>	<u>(15,987,634)</u>

26. Tatimi mbi fitimin

Përlogaritja e shpenzimit për tatimin mbi fitimin paraqitet më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	<u>31 dhjetor 2015</u>	<u>31 dhjetor 2014</u>
Fitimi para tatimit	7,708,047	6,387,424
Shpenzime të panjohura si mëposhtë:	4,359,576	13,862,873
Shpenzime të tjera	4,359,576	13,862,873
Fitimi i tatueshëm	12,067,623	20,250,297
Tatim fitimi 15% (2014: 15%)	1,810,144	3,037,545



TiranaAuto sh.p.k

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

(Vlerat janë në Lek)

Fitim / (humbja) e vitit

5,897,903

3,349,879



Tiranë më, 30 mars 2016

VËRTETIM

Me anë të kësaj shkrese vërtetojmë se ILD-99 Audit sh.p.k është angazhuar për të kryer auditimin e pasqyrave financiare të shoqërisë **"Tirana Auto" sh.p.k** me NIPT K82318007Q dhe seli të regjistruar në adresën: Autostrada Tirane-Durres, Kilometri 1, Rruga Dytesore, Kashar, Tiranë, për vitin ushtrimor të mbyllur më 31 dhjetor 2015.

Ne nuk e kemi përfunduar ende procesin e auditimit dhe në këtë moment nuk jemi në gjendje të lëshojmë raportin e auditimit.

E lëshojmë këtë vërtetim sipas kërkesës së shoqërisë **"Tirana Auto" sh.p.k.**

ILD-99 Audit sh.p.k

Ekspert Kontabel i Regjistruar



Luan Kamberi